

Testime falas për koronavirusin për të punësuarit në shkolla dhe në sektorin e kujdesit për fëmijë: Të gatshme në klinika mjekësore çdo 14 ditë duke filluar nga data 3 Gusht.

Ministria e Punës, Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale ju komunikon:

Të gjithë punonjësit në shkolla publike dhe private si dhe punonjësit në mjediset e kujdesit ditor për fëmijë dhe individët të cilët angazhohen me përkujdesjen ditore të fëmijëve mund të testohen falas me vullnetin e tyre të lirë duke filluar nga dita e hënë, 3 Gusht 2020. Aktualisht, testimet janë në dispozicion çdo 14 ditë deri në 9 Tetor 2020, të alternuara midis mjekëve rezidentë të licencuar (veçanërisht mjekëve të përgjithshëm) dhe qendrave të testimit. Kushti paraprak për këtë është një letër konfirmimi e dorëzuar për testimin nga punëdhënësi përkatës ose për punonjësit e kujdesit ditor të fëmijëve, e dorëzuar nga Zyra për Mirëqenien e të Rinjve (Jugendamt). Një letër përkatëse do të dërgohet këtë javë nga Ministrinë e Familjes dhe të Rinjve (Jugendamt). Të punësuarit dhe personat të cilët angazhohen me përkujdesjen ditore të fëmijëve mund të kontaktojnë doktorët e tyre në çdo kohë për të rezervuar një takim ose për të bërë pyetje.

Ministri i Shëndetësisë Karl-Josef Laumann sqaron: „ Ne kemi përpunuar një procedurë të thjeshtë dhe joburokratike së bashku me Shoqatat e Mjekëve të Sigurimit të Shëndetit Publik (Kassenärztlichen Vereinigungen) për shkollat dhe sektorin e kujdesit ditor për fëmijë, e cila korrespondon fiks me fillimin e testeve falas. Një konfirmim nga punëdhënësi ose Zyra për Mirëqenien e të Rinjve mjafton që ju të testoheni çdo 14 ditë në një klinikë mjekësore të licencuar ose në një qendër testi. E dimë të gjithë: Koronavirusi ekziston akoma. Ne duhet të vazhdojmë të qëndrojmë vigjilentë. Shpresoj që mjediset e testimit falas do t'i japin punonjësve më shumë siguri, në mënyrë që shkollat dhe sektori i kujdesit ditor për fëmijë të mund të rikthehen pak më shumë në normalitet. Dua të falenderoj gjithashtu shprehimisht doktorët të cilët po na mbështesin me testimet.“

Pasqyrë e informacioneve të rëndësishme:

- Një testim falas me vullnet të lirë për koronavirusin është i mundur çdo 14 ditë.
- Oferta për testim vlen shprehimisht për të gjithë punonjësit në mjediset e kujdesit ditor për fëmijë dhe për personat të cilët angazhohen me përkujdesjen e fëmijëve, si dhe gjithashtu për punonjësit e shkollave (Stafi i mësimdhënies, punonjësit e shkollës të hapur gjithë ditën si dhe pjesa tjetër e stafit joedukativ dhe social/edukativ)
- Në mënyrë që të mos mbingarkohen kapacitetet e testimit, është planifikuar një rotacion javor i punonjësve nga sektori i kujdesit ditor për fëmijë dhe i shkollave .
 - o Mundësi testi për punonjësit e mjedisve të kujdesit ditor për fëmijë dhe për personat të cilët janë të angazhuar me përkujdesjen ditore të fëmijëve : KW 32, KW 34, KW 36, KW 38, KW 40
 - o Mundësi testi për punonjësit e shkollave: KW 33, KW 35, KW 37, KW 39, KW 41
- Një letër konfirmimi është e nevojshme për testimin. Ata të cilët përmbushin kushtet për këtë gjë, mund ta marrin këtë letër prej punëdhënësit ose prej bordit drejtues të shkollave ose prej Zyrës për Mirëqenien e të Rinjve.
- Pyesni mjekun ose mjeken nëse ofrojnë një mundësi testi dhe rezervoni një takim. Nëse bini dakord, testimet mund të zhvillohen gjithashtu tek qendrat e kujdesit ditor për fëmijë ose në shkolla.
- Mund të merrni gjithashtu informacione në lidhje me mundësitë e testimit rajonal nëpërmjet linjës telefonike të mjekëve të Shoqatave të Mjekëve të Sigurimit të Shëndetit Publik në numrin 116 117 (Pa takime).

Nëse keni pyetje gazetareske, ju lutem kontaktoni zyrën e shtypit të Ministrisë së Punës, Shëndetësisë dhe të Çështjeve Sociale (Telefon 0211 855-3118).

Kjo deklaratë për shtyp është gjithashtu në dispozicion në internet në adresën e internetit të qeverisë së Republikës <http://www.land.nrw>

[Njoftim për mbrojtjen e të dhënave në lidhje me rrjetet sociale](#)